

VENDIM
Nr. 400, datë 8.5.2013

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 308, DATË 5.5.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË
PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE QË PREKEN NGA NDËRTIMI I RRUGËS
PARALELE TIRANË-VORË (KRAHU I MAJTË)”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5 pika 1, 20 e 21 të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik”, me propozimin e Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në pikën 3 të vendimit nr. 308, datë 5.5.2010 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:
a) Sipërfaqja tokë arë, nga “16 437 (gjashtëmbëdhjetë mijë e katërqind e tridhjetë e shtatë) m²” bëhet “15 473 (pesëmbëdhjetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e tre) m²”.

b) Vlera e tokës arë, nga “6 670 863 (gjashtë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e tre) lekë” bëhet “6 290 083 (gjashtë milionë e dyqind e nëntëdhjetë mijë e tetëdhjetë e tre) lekë”;

c) Vlera e përgjithshme e shpronësimit, nga “78 413 914 (shtatëdhjetë e tetë milionë e katërqind e trembëdhjetë mijë e nëntëqind e katërmëdhjetë) lekë” bëhet “78 033 134 (shtatëdhjetë e tetë milionë e tridhjetë e tri mijë e njëqind e tridhjetë e katër) lekë”.

2. Në numrin rendor 30 të listës bashkëlidhur vendimit, ku pasqyrohen sipërfaqet që shpronësohen, bëhen ndryshimet sipas listës bashkëlidhur këtij vendimi.

3. Pronari i pasurisë së paluajtshme, që shpronësohet, të kompensohet në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse, që paraqitet në tabelën bashkëlidhur këtij vendimi, pasi të ketë paraqitur dokumentacionin e plotë dhe të rifreskuar të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar.

4. Autoriteti Rrugor Shqiptar të bëjë likuidimin sipas pikës 3 të këtij vendimi.

5. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e miratimit të këtij vendimi, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, në bashkëpunim me Autoritetin Rrugor Shqiptar, të fillojnë procedurat për hedhjen e trupit të rrugës në hartat kadastrale, sipas planimetrisë së shpronësimit, që do t’u vihet në dispozicion nga Autoriteti Rrugor Shqiptar dhe të bëjnë kalimin e pronësisë për pasuritë e shpronësuara në favor të shtetit.

6. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, të pezullojnë të gjitha transaksionet me pasuritë e shpronësuara deri në momentin kur do të realizohen: procesi i hedhjes së trupit të rrugës në hartat kadastrale dhe kalimi i pronësisë për pasuritë e shpronësuara.

7. Ngarkohen Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, Ministria e Financave, Autoriteti Rrugor Shqiptar, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Tiranë, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha